# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-477124**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Erdogan pret në Ankara kryeministrin e Nordrhein-Westfalen, takim i pazakontë me fokus te ekonomia dhe vizat |
| ADRESA | `https://tpz.al/erdogan-pret-ne-ankara-kryeministrin-e-nordrhein-westfalen-takim-i-pazakonte-me-fokus-te-ekonomia-dhe-vizat-i334092` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 17:14:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 17:05:27 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5ba15036a2c5b0d7e86a61e73cfaabcbf3602d4d83de6b181036b7c58957df70` |
| TEKSTI | `54381bc8a74234a0141745ce4cc8140352681d73e809bcca367598784778c746` |
| PAMJA | `b08f1cd13d744c796e7b1bd8da7c078584678b2f801a78f80390b43559236168` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7bee8f2eb05b858b25094203483ea9a7affd2dc4dbe523094afd08bd74aaa893` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7bee8f2eb05b858b25094203483ea9a7affd2dc4dbe523094afd08bd74aaa893`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA, 28 SEPTEMBER 2026, 19:05

# Erdogan pret në Ankara kryeministrin e Nordrhein-Westfalen, takim i pazakontë me fokus te ekonomia dhe vizat

TPZ



Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan priti sot në Ankara drejtuesin e landit gjerman të Nordrhein-Westfalen, Hendrik Wust, në një takim të pazakontë ku u diskutuan marrëdhëniet ekonomike, lidhjet mes Turqisë dhe BE-së dhe rregullat për vizat.

Hendrik Wust është kryeministër i landit Nordrhein-Westfalen, një nga 16 njësitë kryesore administrative të Gjermanisë.

Ai konsiderohet nga disa qarqe politike, si një emër që mund të pasojë në të ardhmen kancelarin Friedrich Merz, i cili po përballet me presion politik.

Megjithatë, Wust tha dje se nuk ka ndërmend të bëhet kancelar.

Takimi me Erdogan zgjati rreth 50 minuta dhe është i pazakontë, pasi presidenti turk zakonisht nuk pret në takime drejtuesit e landeve gjermane.

Një arsye për rëndësinë e këtij takimi është se Nordrhein-Westfalen ka komunitetin më të madh me origjinë turke në Gjermani.

Gjatë takimit, Wust kërkoi që të përmirësohen marrëdhëniet ekonomike mes Gjermanisë dhe Turqisë.

Ai mbështeti modernizimin e bashkimit doganor BE-Turqi, rregullave që lehtësojnë tregtinë mes tyre; procedurat e shpejta për vizat e biznesit dhe forcimin e bashkëpunimit me kompanitë turke.

Sipas zyrës së Wust, Turqia po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për kompanitë e Nordrhein-Westfalen, si një vend ku mund të prodhojnë dhe si një mënyrë për të pasur më shumë alternativa për furnizimin me mallra dhe materiale.

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj
Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

**Wust vlerëson komunitetin turk në Gjermani**

Vizita lidhet edhe me 65-vjetorin e marrëveshjes së vitit 1961, përmes së cilës Gjermania Perëndimore lejoi ardhjen e punonjësve nga Turqia për të punuar në vend.

Sot rreth 3 milionë persona me origjinë turke jetojnë në Gjermani.

Rreth një e treta e tyre jetojnë në Nordrhein-Westfalen.

Wust tha se komuniteti turk ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore, duke punuar në industri, ndërtim dhe sektorë të tjerë.

Ai tha gjithashtu se njerëzit me origjinë turke, që njohin gjuhën dhe kulturën gjermane dhe turke, janë një mundësi për të forcuar lidhjet mes dy vendeve.

**Vizita dhe çështja e të drejtave të njeriut**

Gjatë vizitës në Ankara, Wust vizitoi edhe mauzoleun e Mustafa Kemal Ataturk, themeluesit të Turqisë moderne.

Por vizita zhvillohet edhe në një kohë kur Turqia kritikohet për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Negociatat për anëtarësimin e Turqisë në BE, janë pezulluar prej vitesh për shkak të shqetësimeve lidhur me demokracinë, shtetin ligjor dhe të drejtat themelore.

Kritika ka pasur edhe për arrestimin e kundërshtarëve politikë të Erdogan, veçanërisht Ekrem Imamoglu, ish-kryebashkiaku i Stambollit dhe një nga rivalët e tij politikë.

Wust tha se gjatë vizitës, u përqendrua te bashkëpunimi mes Gjermanisë dhe Turqisë, duke argumentuar se çështjet problematike mund të diskutohen më mirë kur marrëdhëniet mes vendeve janë të forta.

BOTA / 28 September 2026, 18:55

BioNTech mbyll tre fabrika në Gjermani

BOTA / 28 September 2026, 18:42

Italia frenon çmimet e karburanteve, vendos tavanin për naftën dhe benzinën

BOTA / 28 September 2026, 18:36

BE miraton 5 projekte të përbashkëta të mbrojtjes, nga dronët te sistemet raketore

BOTA / 28 September 2026, 18:14

Itali/ I prishet makina në autostradë, policia ndalon për ta ndihmuar dhe i gjen mbi 2 kg kokainë, shoferi në pranga

BOTA / 28 September 2026, 18:03

**Fermerja pa burrat e maskuar dhe telefonoi policinë, zbulohet komploti i dyshuar pranë bazës ajrore britanike**

BOTA / 28 September 2026, 17:32

**BE godet me sanksione zyrtarët rusë, në listë edhe gjyqtarë që përjashtuan partinë opozitare "Yabloko"**

BOTA / 28 September 2026, 17:16

**Bateritë e vjetra të makinave elektrike mund të marrin një jetë të dytë, ja si mund të ndihmojnë Europën me energjinë**

BOTA / 28 September 2026, 13:47

**I hiqet imuniteti kryeministrit Péter Magyar dhe dy ish-ministrave të Orbanit në Hungari, i hapet rruga hetimeve**

BOTA / 27 September 2026, 22:19

**Përshkallëzohen tensionet Izrael-Turqi, Netanyahu urdhëron përgatitjen e çështjes kundër Erdogan në Hagë**

BOTA / 27 September 2026, 21:03

**OpenAI nën hetim për agjentët e Inteligjencës Artificiale, anashkaluan filtrat e faqes së OKB-së**

BOTA / 27 September 2026, 19:46

**Magyar sulmohet me vezë gjatë fushatës në Hungari, autori: Më vjen keq që nuk e godita në kokë**

BOTA / 27 September 2026, 19:25

**Trump për arrestimet pranë RAF në Britaninë e Madhe: "Zhvillim fantastik", po planifikonin të shkaktonin**

dëm të madh

BOTA / 27 September 2026, 17:48

## Irani këmbëngul për negociata pas refuzimit të Trumpit për Hormuzin: Vetëm marrëveshja mund t'i japë fund konfliktit

BOTA / 27 September 2026, 17:31

## Rusia lë të hapur transferimin e S-400 nga Turqia, Lavrov: Vendi marrës duhet të jetë mik i Moskës

BOTA / 27 September 2026, 17:29

## Aksident tragjik në Gjermani, dy të vdekur dhe 19 të lënduar në autobusin me turistë

BOTA / 27 September 2026, 17:25

## Stuhia e fuqishme në bregun lindor të SHBA-së, anulohen 400 fluturime, mbi 100 mijë biznese e banesa pa energji elektrike

BOTA / 27 September 2026, 16:39

## Mbi 700 mijë vetë mbushin sheshin në Paris, Papa vlerëson entuziazmin dhe përkushtimin

BOTA / 27 September 2026, 16:18

## Kaos në aeroportin e Katanias pasi Etna shpërtheu sërish, 'fluturojnë' çmimet e biletave

BOTA / 27 September 2026, 16:07

## Polonia ofrohet 'të strehojë' fabrikën e sistemeve "Patriot"

BOTA / 27 September 2026, 10:33

## Alarm pranë bazës ajrore në Britani, evakuohen banorët



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.